



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:163687

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06444806

KPPP.nr. 918/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit "Solid Group" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810159568 dhe seli në Graçanicë, Magjistralja Prishtinë-Shkup KM 7, kundër debitorit "Line Group" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810745317 dhe seli në Pejë, Fusha e Pejës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 456/24 të datës 30.04.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me zyre në Prishtinë, jashtë seancës me datën 13.11.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "Solid Group" Sh.P.K, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.456/24 i datës 30.04.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 78.00 EUR (shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "Solid Group" Sh.P.K, me datë 30.04.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 456/24 duke lejuar përmbartimin ndaj debitorit "Line Group" Sh.P.K., mbi bazë të dokumenteve të besueshme: Fatura Nr. 2000-210-040-23 e datës 23.10.2023 dhe Fatura NR. 2051-210-040-23 e datës 28.10.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij aktvendimi t'ia paguaj kreditorit borxhin e tërësishëm në

shumën prej 1,269.26 EUR (njëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e njëzet e gjashtë cent) me kamatë prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor, me arsyetimin se sipas kartelave financiare të debitorit në lidhje me faturat e pranuar dhe pagesat e realizuara shuma e pretenduar nuk qëndron pasi që pagesa e realizuar përmes P.C.B nuk është evidentuar si pagesë tek kreditori, përkundër faktit se debitori e ka paguar atë dhe nuk ka marrë si kundërvlere mallin e porositur në vlerën prej 257.00 EUR. Shton se duke u bazuar në nenin 71 par.1.7 të LPP-së ka paraqitur prapësim pasi që dokumenti që ka paraqitur kreditori është përmbushur pjesërisht. Tutje thekson se sipas nenit 32, par.3 të LPP-së, debitori është i detyruar të përmbush detyrimin e tij me kusht që në të njëjtën kohë të përmbushen edhe detyrimet që kanë mbetur nga kreditori. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin dhe ka kërkuar që i njëjti të refuzohet, duke theksuar se fatura në të cilat pretendon debitori nuk janë nuk janë objekt i këtij përmbarimi, ashtu që mosmarrëveshjet lidhur me këtë faturë mund të zgjidhen në një procedurë tjetër e jo në kuadër të kësaj procedure. Shton se shkaqet e paraqitura nga debitori në prapësim të njëjtat nuk ekzistojnë dhe se nuk janë të parapara si shkaqe për prapësim në nenin 71 të LPP-së dhe se prapësimi mund të paraqitet ekskluzivisht vetëm për këto shkaqe. Tutje thekson se nuk qëndron pretendimi i debitorit se është përmbushur obligimin që ka ndaj kreditorit sipas faturave që janë objekt i këtij përmbarimi, pasi që i njëjti me asnjë provë nuk e ka vërtetuar këtë. Shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim i ka kërkuar në vlerën prej 104.00 EURO si tarifës së OAK-ut.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*

monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura Nr. 2000-210-040-23 e datës 23.10.2023 dhe Fatura NR. 2051-210-040-23 e datës 28.10.2023, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe se i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit tek pranuesi i faturës dhe të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbaerim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbaerimit pasi që janë të përshtatshme për përmbaerim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se kreditori nuk ka marrë fare për bazë pagesën e bërë nga debitori në shumën prej 257.00 EUR me datë 26.12.2023 por që gjykata gjeti se kjo pagesë nuk i referohet përmbushjes së detyrimeve që derivojnë nga faturat që janë objekt i përmbaerimit në këtë çështje përmbaerimore.

Në vlerësimin e pretendimeve tjera të debitorit të paraqitura me prapësim, gjykata gjeti se nuk plotësohen asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaerimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbaerimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësueses së kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim, në shumën prej 78.00 EUR, konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve të datës 18.03.2017, lidhur me parashtratat për përmbaerimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 918/24, datë 13.11.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.